

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe

Projekti kundër Krimit Ekonomik në Kosovë* (PKEK)

www.coe.int/peck

PYETËSOR

**mbi përputhjen me standardet ndërkombëtare
në fushën e luftimit të pastrimit të parave dhe të
financimit të terrorizmit (LPP/LFT)**

CIKLI 2

ECCU-PECK-alb-3/2013

* Ky shënim është pa paragjykim të qëndrimeve mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të KS të OKB-së dhe Opinionin e GJND-së për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

LËNDA

1. Të përgjithshme	4
1.1 Vështrim i përgjithshëm i [...] Bizneseve dhe Profesioneve të Përcaktuara Jo-Financiare (BPPJF)	4
1.2 Rishikimi i strategjisë për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe zbatimi i saj	4
2. Masat parandaluese - Institucionet Financiare.....	5
2.1 Vigjilenca e duhur ndaj klientëve (R.7 & 8)	5
2.2 Palët e treta dhe biznesi i prezantuar (R.9).....	7
2.3 Mbajtja e shënimeve dhe rregullat e transferit elektronik (RV.VII)	8
2.4 Monitorimi i transaksioneve dhe marrëdhënieve të biznesit (R.11 & 21)	10
2.5 Raportimi i transaksioneve të dyshimta dhe raportimet e tjera (R.19 & 25).....	11
2.6 Kontrollat e brendshme, përputhshmëria, auditimi dhe degët e huaja (R.15 & 22).....	13
2.7 Mbikëqyrja dhe kontrolli (R.25)	15
3. Masat parandaluese - Bizneset dhe profesionet e përcaktuara jo-financiare	16
3.1 Vigjilenca e duhur ndaj klientit dhe mbajtja e shënimeve (R.12)	16
3.2 Raportimi i transaksioneve të dyshimta (R.16).....	24
3.3 Rregullimi, mbikëqyrja dhe monitorimi (R.24-25)	29
3.4 Bizneset dhe profesionet e tjera jo financiare (R.20.1)	33
4. Marrëveshjet Ligjore - Qasja në pronësinë përfituese dhe informacioni i kontrollit (R.34)34	34
5. Bashkëpunimi ndërkombëtar	35
5.1 Ndihma e ndërsjellë juridike (R.36, R.37, SR.V & R.32).....	35
5.2 Ndihma e ndërsjellë juridike për konfiskimin dhe ngrirjen e pasurisë (R.38)	37
5.3 Ekstradimi (R.39, R.37, SR.V dhe R.32)	38
6. Shtojca	40
6.1 Shtojca I – Struktura dhe mbikëqyrja e BPPJF-ve	40
6.2 Shtojca 2: Shkurtime	40

SHËNIM PËR AUTORITETET:

- Autoritetet duhet të japin përgjigje të plota dhe të hollësishme për çdo pyetje më poshtë, dhe të shpjegojnë në një masë sa më të plotë që të jetë e mundur kuadrin ligjor dhe institucional dhe/ose masat e tjera që kanë marrë për plotësimin e çdo kriteri të standardeve ndërkombëtare.
- Në mbështetje të përgjigjeve të pyetësorit të mëposhtëm, autoritetet duhet të ofrojnë kopje të legjislacionit dhe dokumente të tjera, të cilat janë përmendur dhe/ose referuar në përgjigjet ndaj pyetjeve.
- Statistikat e kërkuara duhet të ofrohen (nëse ekzistojnë) në formën e një tablele, të ndara sipas viteve për një periudhë 3-vjeçare.
- Gjatë përgjigjes së pyetjeve që kanë të bëjnë me burimet e agjencisë, ju lutem jepni informacion të hollësishëm për buxhetin, personelin, strukturën si dhe një vlerësim gjithëpërfshirës mbi mjaftueshmërinë e burimeve të ndara.

1. Të përgjithshme

1.1 Vështrim i përgjithshëm i [...] Bizneseve dhe Profesioneve të Përcaktuara Jo-Financiare (BPPJF)

Lutemi të ofroni informacione mbi secilën nga gjashtë kategoritë e bizneseve dhe profesioneve të përcaktuara jo-financiare (BPPJF) siç definohen në Dyzetë Rekomandimet, gjegjësisht: kazinotë (përfshirë kazinotë në internet); agjentët e paluajtshmërive; tregtarët e metaleve të çmuara; tregtarët e gurëve të çmuar; avokatët, noterët, profesionistët e tjerë të pavarur ligjorë dhe llogaritarët; dhe ofruesit e shërbimeve për trustet dhe kompanitë. Kjo pjesë duhet të përshkruajë llojet e aktiviteteve ose bizneseve në të cilët ata zakonisht angazhohen, apo iu lejohet të angazhohen, si dhe informacionet mbi numrin dhe madhësinë e këtyre bizneseve dhe profesionistëve (siç definohet), dhe çfarëdo ndryshimesh të reja me rëndësi.

Lutemi ta plotësoni tabelën në Shtojcën I (Struktura dhe mbikëqyrja e BPPJF-ve)

1.2 Rishikimi i strategjisë për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe zbatimi i saj

[...]

Korniza institucionale për luftimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit

Përshkruani shkurt rolet dhe përgjegjësitë e autoriteteve të ndryshme qeveritare dhe joqeveritare ose organizatave në zbulimin, parandalimin dhe ndërmarrjen e masave shtypëse në lidhje me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, në nivel kombëtar dhe lokal (p.sh. shtetëror ose provincial) për aq sa është e mundur, duke theksuar çfarëdo ndryshimi të ri. Kjo përfshin po ashtu edhe Ministrinë apo organet e përfshira në vendosjen e politikave të LPP/LFT-së.

[...]

BPPJF dhe çështjet e tjera

- Organi për mbikëqyrjen e kazinove
- Autoriteti mbikëqyrës apo autoritet tjetër kompetent, ose OVR, për BPPJF-të
- Organizatat vetërregulluese (OVR) për profesionistët siç janë avokatët dhe llogaritarët
- Çfarëdo agjencioni ose organi tjetër që mund të jetë relevant

2. Masat parandaluese - Institucionet Financiare

2.1 Vigjilenca e duhur ndaj klientëve (R.7 & 8)

Rekomandimi 7

2.1.1 A kërkohet nga institucionet financiare të mbledhin informacione të mjaftueshme në lidhje me institucionin raportues për të kuptuar plotësisht natyrën e biznesit të raportuesit dhe për të përcaktuar nga informacioni publik i disponueshëm reputacionin e institucionit dhe cilësinë e mbikëqyrjes, përfshirë edhe nëse i është nënshtruar hetimit për pastrim të parave apo financim të terrorizmit apo veprimeve rregullative? (FATF R.7.1)

2.1.2 A kërkohet nga institucionet financiare të vlerësojnë kontrollet e LPP/LFT-së të institucionit raportues, dhe të vërtetojnë se ata janë të duhura dhe të efektshme? (FATF R.7.2)

2.1.3 A kërkohet nga institucionet financiare të marrin aprovim nga menaxhmenti i lartë para themelimit të marrëdhënieve të reja korresponduese? (FATF R.7.3)

2.1.4 A kërkohet nga institucionet financiare t'i dokumentojnë¹ përgjegjësitë përkatëse në fushën e LPP/LFT-së për çdo institucion? (FATF R.7.4)

2.1.5 Kur një marrëdhënie korresponduese përfshin mirëmbajtjen e veprimeve “të pagueshme përmes llogarisë”, a mjaftohen institucionet financiare me atë se:
(a) klienti i tyre (institucioni financiar raportues) i ka kryer të gjitha detyrimet e rregullta të VDK-së të përcaktuara në R.5 për klientët e vet që kanë qasje të drejtpërdrejtë në llogaritë e institucionit financiar korrespondues; dhe
(b) institucioni financiar raportues është i aftë të dorëzojë të dhëna përkatëse për identifikimin e klientit në bazë të kërkesës së institucionit financiar korrespondues? (FATF R.7.5)

2.1.6 Luteni të tregoni zbatimin e vigjilencës së shtuar ndaj klientit në marrëdhëniet korresponduese bankare, në veçanti, çfarëdo dallimesh në zbatueshmërinë e tyre për bankat përgjegjëse në Shtetet Anëtare të BE-së apo në juridiksione të tjera? (D3PP Neni. 13 (3))

¹ Nuk është e nevojshme që dy institucionet financiare të kenë gjithmonë nevojë t'i zvogëlojnë përgjegjësitë përkatëse në formë të shkruar atëherë kur është e qartë se cili institucion do t'i kryejë masat e kërkuara.

Rekomandimi 8

2.1.7 A kërkohet që institucionet financiare të kenë politika apo të marrin masa të nevojshme për parandalimin e shpërdorimit të zhvillimit teknologjik në skemat e pastrimit të parave apo të financimit të terrorizmit? (FATF R.8.1)

2.1.8 A kërkohet që institucionet financiare të kenë politika dhe procedura për trajtimin e çfarëdo rreziku specifik, të lidhur me marrëdhëniet apo transaksionet e bizneseve që nuk kryhen ballë për ballë? A zbatohen këto politika dhe procedura kur vendosen marrëdhëniet me klientët dhe kur kryhet vigjilenca e duhur e vazhdueshme ndaj klientit? (FATF R.8.2)

Shembuj të veprimeve ku mungon komunikimi ballë për ballë janë: marrëdhëniet e biznesit të kryera nëpërmjet internetit apo përmes mjeteve të tjera, siç janë përmes postës; shërbimet dhe transaksionet përmes internetit, përfshirë shitblerjen e letrave me vlerë përmes internetit nga investitorët me pakicë apo shërbimet e tjera interaktive kompjuterike; përdorimi i bankomatëve (ATM); shërbimet bankare përmes telefonit; transmetimi i udhëzimeve ose kërkesave nëpërmjet faksit ose mjeteve të ngjashme, si dhe bërja e pagesave dhe tërheqja e parave si pjesë e pikës elektronike të transaksionit të shitjes duke përdorur kartat me vlerë të parapaguara, rimbushëse apo të lidhura me llogarinë.

2.1.9 A përfshijnë masat për menaxhimin e rrezikut procedura të VDK-së specifike dhe të efektshme që zbatohen për klientët që nuk takohen ballë për ballë? (FATF R.8.2.1)

Shembuj të procedurave të tilla janë: vërtetimi i dokumenteve të paraqitura; kërkimi i dokumenteve shitesë si plotësim i atyre që kërkohen për klientët e gjendur ballë për ballë; krijimi i kontakteve të pavarura me klientët; mbështetja në njoftimin nga pala e tretë (shih kriteret 9.1 deri në 9.5) dhe kërkesa që pagesa e parë të realizohet përmes llogarisë në emrin e klientit me një bankë tjetër që u nënshtrohet standardeve të ngjashme për vigjilencën e duhur ndaj klientit.

Institucionet financiare duhet t'i referohen dokumentit të VDK-së, seksioni 2.2.6.

Për shërbimet elektronike, institucionet financiare mund t'u referohen "Parimeve për menaxhimin e rrezikut për shërbimet bankare elektronike", të nxjerra nga Komisioni i Bazelit, i korrikut 2003.

2.1.10 Fusha e Nenit 13(6) të Direktivës së BE-së 2005/60 është më e gjerë se FATF R.8 pasi që Direktiva fokusohet në produktet apo transaksionet pavarësisht nga përdorimi i teknologjisë. Si mbulohen këto çështje në legjislacionin tuaj? (D3PP Neni 13 (6))

2.1.11 Luteni të tregoni se si kërcënimet e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit që dalin nga produktet dhe transaksionet e reja mund të ndikohen nga kërcënime të tjera që rrjedhin prej teknologjive të reja dhe në zhvillim? (D3PP Neni. 13 (6))

2.2 Palët e treta dhe biznesi i prezantuar (R.9)²

2.2.1 A kërkohet që institucionet financiare të cilat mbështeten te një palë e tretë të marrin menjëherë informacionin e nevojshëm nga pala e tretë ³ lidhur me disa elementë të procesit të VDK-së (Kriteret 5.3 deri në 5.6) ⁴ ? (FATF R.9.1)
2.2.2 A kërkohet që institucionet financiare të ndërmarrin hapa të duhur deri sa të binden që kopjet e të dhënave identifikuese dhe dokumentacioni përkatës tjetër lidhur me kërkesat për VDK-në do t'u vihen në dispozicion nga pala e tretë në bazë të kërkesës së bërë dhe pa vonesë? (FATF R.9.2)
2.2.3 A kërkohet që institucionet financiare të binden se pala e tretë është e rregulluar dhe e mbikëqyrur (në përputhje me Rekomandimin 23, 24 dhe 29), dhe se ka vënë në zbatim masat për t'i respektuar kërkesat e VDK-së të përcaktuara në R.5 dhe në R.10? (FATF R.9.3)
2.2.4 Në përcaktimin se në cilat vende mund të vendoset pala e tretë që i plotëson kushtet, a duhet që autoritetet kompetente të marrin parasysh informacionin në dispozicion lidhur me atë nëse ato vende zbatojnë në mënyrë të përshtatshme rekomandimet e FATF-së ⁵ ? (FATF R.9.4)
2.2.5 A bie përgjegjësia përfundimtare për identifikimin dhe verifikimin e klientit mbi BPPJF-në që mbështetet te pala e tretë? (FATF R.9.5)

² Rekomandimi 9 nuk zbatohet për:

(a) kontraktimet apo marrëdhëniet mes agjencive, p.sh. kur agjenti vepron në bazë të marrëveshjes kontraktore me institucionin financiar për të kryer funksionet e tij të VDK-së;

(b) marrëdhëniet e biznesit, llogaritë ose transaksionet ndërmjet institucioneve financiare për klientët e tyre. Këto trajtohen në R.5 dhe R.7.

³ Kopjet e dokumenteve nuk janë të nevojshme për t'u siguruar.

⁴ Në praktikë, kjo mbështetje në palë të treta ndodh shpesh përmes njoftimeve të bëra nga ndonjë anëtar tjetër i të njëjtit grup për shërbime financiare, ose në disa shtete, nga institucioni tjetër financiar ose nga pala e tretë. Kjo mund të ndodhë edhe në marrëdhëniet e biznesit mes kompanive të sigurimit dhe ndërmjetësve/agjentëve të sigurimit ose midis ofruesve të pengut dhe ndërmjetësve.

⁵ Shtetet mund t'u referohen raporteve, vlerësimeve apo shqyrtimeve lidhur me LPP/LFT-në, të cilat janë të botuara nga FATF-ja, FSRB-të, FMN-ja apo nga Banka Botërore.

2.3 Mbajtja e shënimeve dhe rregullat e transferit elektronik (RV.VII)

Rekomandimi i Veçantë VII⁶

2.3.1 Për të gjitha transferet elektronike, prej 1,000 EUR/USD apo më shumë, a kërkohet nga institucionet financiare urdhëruese të marrin dhe mirëmbajnë⁷ informacionet si më poshtë në lidhje me autorin e transferit elektronik:

- emrin e autorit;
- llogarinë bankare të autorit (apo një numër të vetëm referimi nëse nuk ekziston numri i llogarisë); dhe
- adresën e autorit (vendet mund t'iu lejojnë institucioneve financiare ta zëvendësojnë adresën me një numër identifikimi kombëtar, numër të identifikimit të klientit, apo datën dhe vendin e lindjes)? (Ky set i informacioneve referohet si informacion i plotë i autorit).

Për të gjitha transferet elektronike prej 1,000 EUR/USD apo më shumë, institucioni financiar urdhërues duhet të verifikojë identitetin e autorit në pajtim me Rekomandimin 5 (RV FATF VII.2)

2.3.2 Për transferet elektronike ndërkufitare prej 1,000 EUR/USD apo më shumë a kërkohet nga institucioni financiar ta përfshijë informacionin e plotë të autorit në mesazhin apo formularin e pagesës që i bashkangjitet transferit elektronik?⁸ (FATF RV.VII.2)

2.3.3 Për transferet elektronike vendore/të brendshme (përfshirë transaksionet duke përdorur një kartë krediti ose debiti për transfer të parave), a kërkohet nga institucioni financiar urdhërues (a) të veprojë në pajtim me Kriterin VII.2 më lart, ose (b) të përfshijë vetëm numrin e llogarisë së autorit apo identifikuesin unik, brenda mesazhit apo formularit të pagesës. Opsioni i dytë do të duhej të lejohej vetëm nëse informacioni i plotë i autorit mund të ishte i disponueshëm për institucionin financiar

⁶ RV.VII aplikohet në transferet ndërkufitare dhe të brendshme në mes të institucioneve financiare. Megjithatë, RV.VII nuk ka për qëllim të mbulojë llojet e mëposhtme të pagesave:

a. Çdo transfertë që rrjedh nga një transaksion i kryer duke përdorur një kartë kredie ose debite për aq kohë sa numri i kartës së kredisë ose të debisë shoqëron të gjitha transfertat që rrjedhin nga transaksioni, siç janë tërheqjet nga llogaria bankare përmes bankomatit, paradhënies së parave në dorë nga karta e kredisë apo pagesat për mallra dhe shërbime. Megjithatë, kur karta e kredisë ose debisë janë përdorur si një sistem pagese për të kryer një transfertë parash, ato janë të mbuluara nga RV VII, dhe informacioni i domosdoshëm duhet të përfshihet në mesazh.

b. Transfertat nga një institucion financiar në një tjetër dhe shlyerjet kur së bashku si dërguesi ashtu edhe përfituesi janë institucione financiare që veprojnë në emër të vet.

⁷ Institucionet financiare nuk janë të detyruara të marrin vazhdimisht informata për autorin dhe të verifikojnë identitetin e tij sa herë që klienti bën një transfertë telegrafike. Institucionet financiare mund të mbështeten në informacionin që është tashmë në dispozicion nëse, në kuadër të procesit të vigjilencës së duhur ndaj klientit, ata kanë marrë:

(i) emrin e autorit;

(ii) numrin e llogarisë (ose numrin e vetëm referues, nëse nuk ekziston numri i llogarisë rrjedhëse) dhe

(iii) adresën (ose numrin identifikues shtetëror, numrin identifikues të klientit ose datën dhe vendin e lindjes, nëse shteti lejon që njëra prej këtyre informatave të zëvendësojë adresën).

dhe kanë verifikuar identitetin e autorit në përputhje me Rekomandimin 5 (shih, në veçanti, kriterin 5.3). Kjo nuk zbatohet për klientët e rastësishëm.

⁸ Megjithatë, kur disa transfertat individuale telegrafike ndërkufitare (prej 1,000 EUR/USD ose më shumë) nga një autor i vetëm vendosen në një skedar përmbljedhës për transmetim te përfituesit në një shtet tjetër, institucioni financiar urdhërues duhet të përfshijë vetëm numrin e llogarisë së autorit apo identifikuesin e vetëm për secilën transfertë individuale ndërkufitare, me kusht që skedari përmbljedhës (ku janë të vendosura transfertat individuale) të përmbajë informatat e plota të autorit, të cilat janë plotësisht të gjurmueshme në shtetin pritës.

përfitues dhe për autoritetet përkatëse brenda tri ditëve të punës prej marrjes së kërkesës, dhe autoritetet vendore të zbatimit të ligjit mund ta bëjnë prodhimin e tij të menjëhershëm? (FATF RV.VII.3)
2.3.4 A kërkohet nga çdo institucion financiar ndërmjetës dhe përfitues në zinxhirin e pagesës të sigurohet se të gjitha informacionet e autorit që e përcjellin një transfer elektronik të transmetohen me transferin? (FATF RV.VII.4)
2.3.5 Kur kufizimet teknike pengojnë që informacioni i plotë për dërguesin i cili shoqëron një transfertë telegrafike ndërkufitare të mbetet me një transfertë telegrafike të brendshme të lidhur (gjatë kohës së duhur për të përshtatur sistemet e pagesës), a mbahen shënime/ procesverbal për pesë vite nga institucioni financiar ndërmjetës pritis për të gjitha informacionet e marra nga institucioni financiar urdhërues? (FATF RV.VII.4.1)
2.3.6 A kërkohet nga institucionet financiare përfituese të adoptojnë procedura efektive të bazuara në rreziqe për të identifikuar dhe menaxhuar transferet elektronike në të cilat mungon informacioni i plotë për dërguesin? Mungesa e informacionet të plotë të autorit mund të konsiderohet si një faktor në vlerësimin nëse një transfer elektronik apo transferet e ndërlidhura janë të dyshimta dhe, sipas rastit, nëse kërkohet që ato të raportohen tek njësi i inteligjencës financiare apo autoritetet e tjera kompetente. Në disa raste, institucioni financiar përfitues duhet ta konsiderojë kufizimin ose ndërprerjen e marrëdhënies së vet afariste me institucionet financiare që nuk i përmbushin standardet e RV.VII (FATF RV.VII.5)
2.3.7 A ka Kosova masa për ta monitoruar efektivisht përputhshmërinë e institucioneve financiare me rregullat dhe rregulloret që implementojnë RV.VII? (FATF RV.VII.6)
2.3.8 A siguron Kosova se kriteret 17.1-17.4 (në R.17) ⁹ aplikohen gjithashtu në lidhje me detyrimet sipas RV.VII? (FATF RV.VII.7)
2.3.9 A kërkon Kosova që të gjitha transferet elektronike pranuese ndërkufitare (përfshirë ato prej më pak se 1,000 EUR/USD) të përmbajnë informacionin e plotë dhe të saktë të autorit? (FATF RV.VII.8)

⁹ Shih seksionin 3.11 (Sanksionet) të Pyetësorit LPP/LFT të PECK të Ciklit 1.

2.3.10 A kërkon Kosova që të gjitha transferet elektronike dërguese ndërkufitare prej më pak se 1,000 EUR/USD të përmbajnë informacion të plotë dhe të saktë të autorit? (FATF RV.VII.9)

2.4 Monitorimi i transaksioneve dhe marrëdhënieve të biznesit (R.11 & 21)

Rekomandimi 11

2.4.1 A kërkohet që institucionet financiare t'u kushtojnë vëmendje të veçantë të gjitha transaksioneve të mëdha komplekse dhe të pazakonshme, ose modeleve të pazakonshme të transaksioneve, të cilat nuk kanë qëllim të dukshëm ekonomik apo të ligjshëm? (FATF R.11.1)

Shembuj të këtyre transaksioneve apo modeleve të transaksioneve janë: transaksionet e mëdha në lidhje me një marrëdhënie ekzistuese të biznesit, transaksionet që kalojnë kufij të caktuar, qarkullim i lartë në llogari që është në mospërputhje me shumën e gjendjes në llogari apo transaksionet që dalin jashtë modelit të rregullt të veprimtarisë së llogarisë.

2.4.2 A kërkohet që institucionet financiare të analizojnë sa më shumë që të jetë e mundur historikun dhe qëllimin e këtyre transaksioneve dhe të paraqesin konstatimet e tyre me shkrim? (FATF R.11.2)

2.4.3 A kërkohet që institucionet financiare t'i mbajnë këto gjetje të konstatimeve në dispozicion të autoriteteve kompetente dhe auditorëve për të paktën pesë vjet? (FATF R.11.3)

Rekomandimi 21

2.4.4 A kërkohet që institucionet financiare t'u kushtojnë vëmendje të veçantë marrëdhënieve të biznesit dhe transaksioneve me persona (përfshirë personat juridikë dhe institucionet e tjera financiare) nga apo në shtetet, të cilat nuk i zbatojnë rekomandimet e FATF-së apo nuk i zbatojnë ato në mënyrë të mjaftueshme? (FATF R.21.1)

2.4.5 A ka Kosova masa të efektshme për t'u siguruar që institucionet financiare të jenë të njoftuara për shqetësimet rreth dobësive në sistemet e LPP/LFT-së së shteteve/juridiksioneve të tjera? (FATF R.21.1.1)

2.4.6 Nëse këto transaksione nuk kanë qëllim të qartë ekonomik apo në dukje të ligjshëm, a shqyrtohen, për aq sa është e mundur, prejardhja dhe qëllimi i atij transaksioni dhe a vihen në dispozicion konstatimet me shkrim për të ndihmuar autoritetet kompetente (p.sh. mbikëqyrësit, agjencitë për zbatimin e ligjit dhe NjIF-in), si dhe auditorët? (FATF R.21.2)
2.4.7 Në rastet kur një shtet/juridiksion vazhdon të mos zbatojë rekomandimet e FATF-së apo nuk i zbaton ato sa duhet, a është Kosova në gjendje të zbatojë kundërmasa të përshtatshme? (FATF R.21.3)
<i>Shembuj të kundërmasave të mundshme janë:</i> - Kërkesat e rrepta për identifikimin e klientëve dhe përmirësimi i këshillave, përfshirë këshillat specifike financiare për juridiksionin e atij shteti, për institucionet financiare me qëllimin e identifikimit të pronarëve përfutës para krijimit të marrëdhënieve të biznesit me individë apo kompani nga këto shtete; - Mekanizma të përmirësuar raportues apo raportim sistematik i transaksioneve financiare në bazë të asaj që transaksionet financiare me këto shtete kanë më shumë gjasa të jenë të dyshimta; - Gjykimi i kërkesave për miratimin e themelimit në shtetet që zbatojnë kundërmasën të degëve apo zyrave përfaqësuese të institucioneve financiare, duke marrë parasysh faktin që institucioni përkatës financiar vjen nga vendi që nuk ka sisteme të duhura të LPP/LFT-së; - Paralajmërimi i bizneseve nga sektori jofinanciar që transaksionet me personat fizikë apo juridikë në atë shtet mund të përmbajnë rrezikun e pastrimit të parave. - Kufizimi i marrëdhënieve të biznesit apo i transaksioneve financiare me shtetin apo personat e identifikuar në atë shtet.

2.5 Raportimi i transaksioneve të dyshimta dhe raportimet e tjera (R.19 & 25)

Rekomandimi 25 (vetëm informacion mbështetës dhe udhëzim në lidhje me RTD)

2.5.1 A u ofrojnë autoritetet kompetente, dhe në veçanti NjIF-i, institucioneve financiare dhe BPPJF-ve që duhet të raportojnë transaksionet e dyshimta, informata të duhura dhe të përshtatshme, duke pasur parasysh Udhëzimet e FATF-së për praktikën më të mira për dhënien e informatave institucioneve financiare raportuese dhe personave të tjerë?? (FATF R.25.2)
<i>Shembuj të mekanizmave të duhur të dhënies së informatave (të nxjerra nga dokumenti i Praktikave më të mira) janë:</i> (i) komente të përgjithshme - (a) statistika për numrin e raporteve, të ndara në mënyrën e duhur, dhe rezultatet e raporteve; (b) informata për teknikat, metodat dhe prirjet e sotme (tipologjitë), (c) shembuj të rasteve të përfunduara kundër pastrimit të parave. (ii) komente specifike ose komente rast pas rasti - (a) vërtetimi i pranimit të raportit; (b) në varësi të parimeve ligjore vendase, nëse rasti është i mbyllur apo i përfunduar, qoftë për shkak të përfundimit të ndjekjes penale, për shkak se raporti ka konstatuar se bëhet fjalë për një transaksion të ligjshëm apo për arsye të tjera, dhe nëse informacioni është në dispozicion, atëherë institucioni duhet të marrë informacion për atë vendim ose rezultat.

--

Rekomandimi 19

2.5.2 A e ka marrë Kosova parasysh mundësinë dhe dobinë e zbatimit të një sistemi ku institucionet financiare i raportojnë të gjitha transaksionet në valutë mbi kufirin e përcaktuar tek një agjenci qëndrore kombëtare nëpërmjet një baze të kompjuterizuar të dhënash? (FATF R.19.1)

--

2.5.3 Kur ekzistojnë sistemet për raportimin e transaksioneve të mëdha të valutës, a mbahen raportet në bazën e kompjuterizuar të të dhënave, që është në dispozicion të autoriteteve kompetente për qëllimet e LPP/LFT-së? (FATF R.19.2)

--

2.5.4 A u nënshtrohen sistemet për raportimin e transaksioneve të mëdha në valutë masave të rrepta mbrojtëse për të siguruar shfrytëzimin e duhur të informatave ose të dhënave të raportuara apo të regjistruara? (FATF R.19.3)
--

--

2.5.5 A mbajnë autoritetet kompetente statistika të plota për çështjet e lidhura me efektshmërinë dhe efikasitetin e sistemeve për luftimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit? Kjo duhet të përfshirë mbajtjen e statistikave vjetore për:

(a) raportet për transaksione të dyshimta, dhe raportet e tjera, kur është e mundur sipas legjislacionit vendas, qofshin të marra dhe të shpërndara -

(iii) oRaportet e dorëzuara për: (i) transaksionet në valutë vendase apo të huaja mbi një prag të përcaktuar.

Nëse mbahen, luteni të ofroni statistika (FATF R.32.2)
--

--

2.6 Kontrollet e brendshme, përputhshmëria, auditimi dhe degët e huaja (R.15 & 22)

Rekomandimi 15

2.6.1 A kërkohet që institucionet financiare të vendosin dhe të mbajnë procedura, politika dhe kontrole të brendshme për parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit, si dhe t'ua komunikojnë ato punonjësve të tyre? A mbulojnë këto procedura, politika dhe kontrole, ndër të tjera, VDK-në, mbajtjen e regjistrave, zbulimin e transaksioneve të pazakonshme dhe të dyshimta dhe detyrimin për raportim? (FATF R.15.1)
2.6.2 A kërkohet që institucionet financiare të bëjnë rregullimet e duhura për menaxhimin e përputhshmërisë? P.sh. për BPPJF-të, duhet të paktën të caktohet zyrtari përgjegjës për përputhshmërinë me LPP/LFT-në në nivelin e menaxhimit? (FATF R.15.1.1)
2.6.3 A kanë qasje në kohë zyrtari i përputhshmërisë me LPP/LFT-në dhe punonjësit e tjerë të duhur në të dhënat identifikuese të klientit dhe në informata të tjera për VDK-në, në regjistra të transaksioneve dhe në informacionin tjetër përkatës? (FATF R.15.1.2)
2.6.4 A kërkohet që institucionet financiare të mbajnë një funksion auditi me burimet e duhura dhe të pavarur me qëllimin e testimit të përputhshmërisë (përfshirë testimin e shembujve) me këto procedura, politika dhe kontrole? (FATF R.15.2)
2.6.5 A organizojnë institucionet financiare trajnime të vazhdueshme për të punësuarit për t'u siguruar që punonjësit të mbahen të informuar për zhvillimet e reja, përfshirë informacionin për teknikat, metodat dhe prirjet e tanishme të PP-së dhe FT-së; dhe a ekzistojnë shpjegime të qarta për të gjitha aspektet e ligjeve dhe detyrimeve për LPP/LFT-në dhe, në veçanti, për kërkesat lidhur me VDK-në dhe raportimin e transaksioneve të dyshimta? (FATF R.15.3)
2.6.6 A kërkohet që institucionet financiare të krijojnë procedura të kontrollit për të siguruar standarde të larta në lidhje me punësimin e punonjësve? (FATF R.15.4)
2.6.7 A është zyrtari përgjegjës për përputhshmërinë me LPP/LFT-në në gjendje të veprojë në mënyrë të pavarur dhe t'i raportojë nivelit të tij epror që gjendet një nivel më lart se niveli i vet i

raportimit apo bordit të drejtorëve? (FATF R.15.5)

Rekomandimi 22

2.6.8 A kërkohet nga institucionet financiare të sigurojnë që degët e huaja dhe filialet e tyre të respektojnë masat e LPP/LFT-së në pajtim me kërkesat e juridiksionit vendor dhe Rekomandimet e FATF, deri në masën që lejohet nga ligjet dhe rregulloret vendore (p.sh. vendi/juridiksioni pritës)? (FATF R.22.1)
2.6.9 A kërkohet nga institucionet financiare t'i kushtojnë vëmendje të vecantë respektimit të këtij parimi nga degët dhe filialet e tyre në vendet/juridiksionet të cilat nuk i aplikojnë ose nuk i aplikojnë mjaftueshëm Rekomandimet e FATF? (FATF R.22.1.1)
2.6.10 Në rastet kur kërkesat minimale të LPP/LFT-së në vendet e prejardhjes dhe pritëse dallojnë, a kërkohet nga degët dhe filialet në Kosovë të aplikojnë standardin më të lartë për aq sa e lejojnë ligjet dhe rregulloret në Kosovë? (FATF R.22.1.2)
2.6.11 A kërkohet nga institucionet financiare ta informojnë mbikqyrësinë e juridiksionit vendor kur një degë e huaj ose filial nuk ka mundësi t'i respektojë masat e duhura të LPP/LFT-së sepse kjo ndalohet nga ligjet, rregulloret apo masat e tjera vendore (p.sh. të vendit/juridiksionit pritës)? (FATF R.22.2)
2.6.12 A kërkohet nga institucionet financiare që u nënshtrohen Parimeve Themelore që kërkohen për zbatimin e masave të qëndrueshme të VDK-së në nivelin e grupit, duke marrë parasysh veprimtarinë e klientit me degë të ndryshme dhe filiale që janë në zotërim të shoqërive mëmë në mbarë botën? (FATF R.22.3)
2.6.13 Kur ligjet e vendit të tretë nuk lejojnë zbatimin e masave të barasvlershme të LPP/LFT-së, luteni të tregoni procedurat ekzistuese në Kosovë për institucionet për të marrë masa shtesë për të trajtuar rrezikun e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe llojin e masave shtesë të pritshme për t'u vënë në zbatim (D3PP Neni 31 (3))
2.6.14 Luteni të tregoni nëse institucionet kreditore dhe financiare duhet të komunikojnë politikat dhe procedurat e tyre të brendshme të LPP/LFT-së tek degët dhe shumicën e filialeve të tyre në pronësi në vendet (jashtë BE-së) e treta? (D3PP Neni. 34 (2))

2.7 Mbikëqyrja dhe kontrolli (R.25)

Udhëzimet – R.25 (Direktiva për institucionet financiare)

2.7.1 A kanë hartuar autoritetet kompetente udhëzime ¹⁰ që do të ndihmojnë institucionet financiare dhe BPPJF-të për të zbatuar dhe respektuar kërkesat përkatëse për LPP/LFT-në ? Për BPPJF-të, këto udhëzime mund të hartohen nga OVR-rr-të. (FATF R.25.1)

¹⁰ Udhëzimet duhet që të paktën të ndihmojnë për çështjet e mbuluara nga rekomandimet përkatëse të FATF-së, duke përfshirë: (i) përshkrimin e teknikave dhe metodave të PP-së dhe FT-së dhe (ii) çdo masë shtesë që këto institucione dhe BPPJF-të do të mund të marrin për të siguruar se masat e tyre të LPP/LFT-së janë të efektshme.

3. Masat parandaluese - Bizneset dhe profesionet e përcaktuara jo-financiare

3.1 Vigjilenca e duhur ndaj klientit dhe mbajtja e shënimeve (R.12)

(aplikimi i R.5, 6, 8-11 & 17 (vetëm sanksionet për këto rekomandime)

3.1.1 Luteni të jepni një vështrim të përmblendhur për fushën e mbulimit të masave parandaluese të LPP/LFT-së siç aplikohen për BPPJF-të p.sh. cilët sektorë janë të mbuluar dhe deri në çfarë mase.

3.1.1/1 Për sa i përket kontabilistëve të huaj, a i zbaton Kosova të gjitha detyrimet për të gjitha aktivitetet e tyre profesionale apo ato janë të kufizuara në transaksione të veçanta? (D3PP Neni 2(3)(a))

3.1.1/2 Specifikoni nëse Kosova zbaton të gjitha detyrimet për të gjithë personat fizikë dhe juridikë që tregtojnë mallra kur pagesat janë bërë në para të gatshme në vlerën prej 15,000 € ose më shumë (D3PP Neni 2(3)(e)).

3.1.1/3 Në lidhje me identifikimin e klientit në kazinotë, a mundet Kosova të specifikojë nëse kufijtë ekzistues ndjekin Direktivën e BE-së dhe nëse blerja dhe shitja e xhetonave të lojës janë gjithashtu objekt identifikimi ose nëse në kazinotë që i nënshtrohen mbikëqyrjes së shtetit të gjithë klientët regjistrohen dhe identifikohen menjëherë gjatë hyrjes (D3PP Neni 10).

3.1.2 A kërkohet që BPPJF-të të respektojnë kërkesat e përcaktuara në Rekomandimin 5 (kriteret 5.1 – 5.18) në rrethanat e mëposhtme¹¹:

a) Kazinotë (përfshirë kazinotë përmes internetit¹²) – kur klientët e tyre përfshihen në transaksione financiare¹³ të barabarta apo më shumë se 3,000 USD/€¹⁴.

¹¹ Kufijtë e përcaktuar të zbatuar në këto kriterë përmenden në Shënimin Shpjegues të R. 5, 12 dhe 16.

¹² Shtetet duhet të vendosin rregulla për përcaktimin e bazës, sipas së cilës kazinotë e internetit u nënshtrohen kërkesave shtetërore të LPP/LFT-së. Kjo do të kërkojë që shteti të përcaktojë bazën apo faktorët, në bazë të të cilëve ai do të vendosë nëse ka lidhje të mjaftueshme ndërmjet kazinosë në internet dhe shtetit. Shembuj të faktorëve të tillë përfshijnë përfshirjen apo organizimin në bazë të ligjeve të shtetit ose vendin e menaxhimit të efektshëm brenda shtetit. Vlerësuesit duhet të shqyrtojnë bazën për këtë lidhje në mbështetje të R.12, 16 dhe 24.

¹³ Shënim për vlerësuesit: Rekomandimi 12 (c.12.1) kërkon që kazinotë (përfshirë ato të internetit) të zbatojnë Rekomandimin 5, përfshirë identifikimin dhe verifikimin e identitetit të klientëve, në rastin kur klienti i tyre hyn në transaksione financiare të barabarta apo më shumë se me 3,000 USD/€. Identifikimi i klientit në hyrje të kazinosë, mund të jetë, por nuk është domosdoshmërisht, i mjaftueshëm. Shtetet duhet të kërkojnë që kazinotë të sigurojnë se janë në gjendje të lidhin informacionin e mbledhur nga vigjilenca e duhur ndaj klientit për një klient të veçantë me transaksionet që klienti kryen në kazino.

¹⁴ Kufijtë e përcaktuar prej 3,000 USD/€ dhe 15,000 USD/€ përfshijnë situatat kur transaksioni realizohet në kuadër të një veprimi të vetëm apo në disa veprime që duket se janë të lidhura.

b) Agjentët e pasurive të patundshme – në rastet kur janë të përfshirë në transaksione në emër të klientit lidhur me blerjen dhe shitjen e pasurisë së patundshme¹⁵. c) Tregtarët e metaleve të çmuara dhe të gurëve të çmuar – në rastin e përfshirjes në çdo transaksion me para në dorë me klientin në shuma të barabarta ose më të larta se 15,000 USD/€. d) Avokatët, noterët, profesionistët e tjerë ligjorë të pavarur dhe kontabilistët kur përgatiten për transaksionin financiar apo kur e realizojnë atë për një klient lidhur me veprimtaritë e mëposhtme: • Blerjen dhe shitjen e pronës së patundshme; • Menaxhimin e parave, letrave me vlerë apo pasurive të tjera të klientit¹⁶; • Menaxhimin e llogarive bankare, të kursimeve ose të letrave me vlerë; • Organizimin e kontributeve për krijimin, funksionimin apo menaxhimin e kompanive; • Themelimin, funksionimin apo menaxhimin e personave juridikë apo të marrëveshjeve, si dhe shitblerjen e enteve të biznesit. e) Ofruesit e shërbimeve për trustet dhe kompanitë kur përgatiten ose kryejnë transaksione për një klient lidhur me veprimtaritë si më poshtë: • veprojnë si agjentë themelues të personave juridikë; • veprojnë si (ose i mundësojnë një personi tjetër të veprojë si) drejtor apo sekretar i kompanisë, partner i partneritetit ose në një pozicion të ngjashëm lidhur me personat e tjerë juridikë; • sigurojnë një zyrë të regjistruar, adresë apo strehim për biznesin; adresë letërkëmbimi apo administrative për kompani, partneritet ose çdo person a marrëveshje tjetër juridike; • veprojnë si (ose i mundësojnë një personi tjetër të veprojë si) i besuar i trustit të shprehur; • veprojnë si (ose i mundësojnë një personi tjetër të veprojë si) aksionar i emëruar për një person tjetër. BPPJF-të duhet veçanërisht të plotësojnë masat e VDK-së, të parashikuara në kriteret 5.3 deri në 5.7, por mund të përcaktojnë shtrirjen e atyre masave në bazë të rrezikut dhe në varësi të llojit të klientit, marrëdhënies së biznesit apo transaksionit. (FATF R.12.1)

3.1.2/1 A lejohet që BPPJF-të të mbajnë llogari anonime apo llogari me emra fiktivë? (FATF R.5.1)

3.1.2/2 A kërkohet që BPPJF-të të ndërmarrin masa për vigjilencën e duhur ndaj klientit (VDK) kur:

- a) vendosin marrëdhënie biznesi;
- b) kryejnë transaksione të rastit mbi pragun e përcaktuar të zbatueshëm (15,000 USD/€);
- c) kryejnë transaksione të rastit të cilat janë transferta telegrafike;
- d) ekziston dyshimi i pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, pavarësisht ndonjë përjashtimi apo pragu; ose
- e) institucioni financiar ka dyshime në lidhje për vërtetësinë apo mjaftueshmërinë e të dhënave të siguruar më parë për identifikimin e klientit? (FATF R.5.2)

Shembuj të transaksioneve financiare në kazino janë: blerja e xhetonëve të kazinosë apo arkëtimi i tyre në para, hapja e llogarive, transfertat telegrafike dhe këmbimet e valutave. Transaksionet financiare nuk u referohen transaksioneve në lojërat e fatit që përfshijnë vetëm xhetonët e kazinosë.

¹⁵ Kjo do të thotë se agjentët e pasurive të patundshme duhet të respektojnë R.5, duke përfshirë si blerësit, ashtu edhe shitësit e pronës.

¹⁶ Në rastet kur avokati, noteri, profesionisti tjetër i pavarur juridik apo kontabilisti kryejnë veprimtari financiare si biznes dhe hyjnë në kuadër të përkufizimit të “institucionit financiar”, atëherë ai person apo firmë duhet të plotësojë kërkesat që zbatohen për institucionet financiare.

3.1.2/3 A kërkohet që BPPJF-të të identifikojnë klientët (qofshin ata të përhershëm apo të rastit, dhe qofshin ata persona fizikë apo juridikë a marrëveshje juridike) dhe të verifikojnë identitetin e klientëve duke shfrytëzuar dokumente, të dhëna apo informata burimore të pavarura dhe të besueshme (të dhëna identifikuese)? (FATF R.5.3)
3.1.2/4 Për klientët të cilët janë persona juridikë apo marrëveshje juridike, a kërkohet që BPPJF-ja të: (a) verifikojë se çdo person që pretendon se vepron në emër të klientit është i autorizuar për këtë, dhe të identifikojë dhe verifikojë identitetin e këtij personi; dhe (b) verifikojë statusin ligjor të personit juridik ose marrëveshjes juridike ¹⁷ ? (FATF R.5.4)
3.1.2/5 A kërkohet që BPPJF-të të identifikojnë pronarin përfitues ¹⁸ , dhe të marrin masat e arsyeshme për të verifikuar identitetin e pronarit përfitues duke përdorur informata përkatëse apo të dhëna të siguruar nga burime të besueshme të tilla që institucioni financiar të jetë i kënaqur se ka dijeni se kush është pronari përfitues? (FATF R.5.5)
3.1.2/6 Për të gjithë klientët, a duhet që BPPJF-ja të përcaktojë nëse klienti është duke vepruar në emër të një personi tjetër, dhe të ndërmarrë hapat e arsyeshëm për të siguruar të dhëna të mjaftueshme identifikuese për të verifikuar identitetin e atij personit tjetër? (FATF R.5.5.1)
3.1.2/7 Për klientët të cilët janë persona juridikë apo marrëveshje juridike, a kërkohet që BPPJF-ja të ndërmarrë masat e arsyeshme për të: (a) kuptuar strukturën e pronësisë dhe të kontrollit të klientit; (b) përcaktuar se cilët janë personat juridikë që në fund të fundit zotërojnë dhe kontrollojnë klientin. (FATF R.5.5.2)
3.1.2/8 A kërkohet që BPPJF-të të sigurojnë informata për qëllimin dhe natyrën e synuar të marrëdhënies së biznesit? (FATF R.5.6)

¹⁷ Verifikimi mund të kryhet duke marrë prova të përfshirjes apo dëshmi të ngjashme të themelimit apo ekzistencës, dhe duke marrë informata në lidhje me emrin e klientit, emrat e administruesve të besuar (për trustet), formën ligjore, adresën, drejtorët (për personat juridikë), dhe dispozitat të cilat rregullojnë autoritetin për të detyruar personat apo marrëveshjet juridike.

¹⁸ *Pronari përfitues* i referohet personit/personave juridikë të cilët në fund të fundit zotërojnë ose kontrollojnë një klient dhe/ose një person në emër të të cilit është kryer një transaksion. Ai përfshin gjithashtu ata persona të cilët ushtrojnë kontroll efektiv përfundimtar ndaj personave apo marrëveshjeve juridike.

3.1.2/9 A kërkohet që BPPJF-të të kryejnë vigjilencë të duhur të vazhdueshme në marrëdhëniet e biznesit? (FATF R.5.7)
3.1.2/10 A përfshin vigjilenca e duhur e vazhdueshme shqyrtimin e transaksioneve të ndërmarra gjatë vazhdimit të asaj marrëdhënieje për të siguruar që transaksionet të cilat janë duke u kryer janë në përputhje me njohuritë e institucionit për klientët, bizneset e tyre dhe profilin e riskut, dhe kur është e domosdoshme, burimet e financimit? (FATF R.5.7.1)
3.1.2/11 A kërkohet që BPPJF-të të sigurojnë që dokumentet, të dhënat apo informatat e mbledhura gjatë procesit të vigjilencës së duhur ndaj klientit, të mbahen të azhurnuara dhe të jenë të përshtatshme duke ndërmarrë rishikimin e regjistrimeve ekzistuese, në veçanti për kategoritë e klientëve apo të marrëveshjeve të biznesit me rrezik të lartë? (FATF R.5.7.2)
3.1.2/12 A kërkohet që BPPJF-të të kryejnë vigjilencë të duhur të shtuar për kategoritë e klientëve, të marrëveshjeve të biznesit apo transaksioneve me rrezik të lartë? (FATF R.5.8)
3.1.2/13 Në rastet kur ekzistojnë rreziqe të ulëta, a mundën BPPJF-të të zbatojnë masa të zvogëluara apo të thjeshtuara? (FATF R.5.9)
3.1.2/14 A lejohen BPPJF-të të zbatojnë masa të zvogëluara apo të thjeshtuara të vigjilencës së duhur ndaj klientit për klientët rezidentë në një juridiksion tjetër? (FATF R.5.10)
3.1.2/15 Kur ekziston dyshimi për pastrim të parave ose financim të terrorizmit apo nëse zbatohen skenarë të veçantë me rrezik të lartë, a janë të pranueshme masat e thjeshtuara të vigjilencës së duhur ndaj klientit? (FATF R.5.11)
3.1.2/16 Kur BPPJF-të lejohen që të përcaktojnë shtrirjen e masave të vigjilencës së duhur ndaj klientit mbi bazën e një rreziku të ndjeshëm, a ekzistojnë kërkesa për të zbatuar udhëzimet e lëshuara nga autoritetet kompetente? (FATF R.5.12)

3.1.2/17 A kërkohet që BPPJF-të të verifikojnë identitetin e klientit dhe të pronarit përfitues para apo gjatë rrjedhës së vendosjes së marrëdhënies së biznesit apo gjatë kryerjes së transaksioneve për klientë të rastit? (FATF R.5.13)
3.1.2/18 A lejohen BPPJF-të në Kosovë të plotësojnë verifikimin e identitetit të klientit dhe të pronarit përfitues pas vendosjes së marrëdhënies së biznesit, me kusht që: (a) kjo të ndodhë sa më shpejt që të jetë e mundur. (b) kjo të jetë thelbësore për të mos ndërprerë zhvillimin normal të biznesit. (c) Rreziqet e pastrimit të parave të menaxhohen në mënyrë efektive? (FATF R.5.14)
3.1.2/19 Kur klientit i lejohet ta shfrytëzojë marrëdhënien e biznesit para verifikimit, a kërkohet që BPPJF-të të miratojnë procedura të menaxhimit të rrezikut në lidhje me kushtet nën të cilat kjo mund të ndodhë? ¹⁹ (FATF R.5.14.1)
3.1.2/20 Nëse BPPJF-ja nuk është në gjendje të përmbushë kriteret (FATF R.5.3 to 5.6) e mësipërme: a) a lejohet që të hapet llogari, të nisë marrëdhënie biznesi apo të kryejë transaksionin? b) a kërkohet që të merret parasysh kryerja e një raporti të transaksionit të dyshimtë? (FATF R.5.15)
3.1.2/21 Nëse BPPJF-ja ka filluar tashmë marrëdhëniet e biznesit, a ekziston ndonjë kërkesë për të përfunduar marrëdhënien e biznesit dhe të merret parasysh kryerja e një raporti të transaksionit të dyshimtë? (FATF R.5.16)
3.1.2/22 A kërkohet që BPPJF-të të zbatojnë kërkesat e vigjilencës së duhur ndaj klientit për klientët ekzistues mbi bazën e rëndësisë dhe rrezikut dhe të kryhet vigjilencë e duhur në kohën e përshtatshme për marrëdhënie të tilla ekzistuese? (FATF R.5.17)

¹⁹ Këto procedura duhet të përfshijnë një gamë masash, si kufizimi i numrit, llojeve dhe/ose sasisë së transaksioneve, të cilat mund të kryhen dhe monitorimi i transaksioneve të mëdha apo të ndërlikuara të cilat kryhen jashtë normave të pritshme për atë lloj marrëdhënieje.

3.1.2/23 A kërkohet që BPPJF-të të zbatojnë masat e vigjilencës së duhur ndaj klientit për klientët ekzistues nëse ata janë klientë ndaj të cilëve zbatohet kriteri 5.1? (FATF R.5.18)
3.1.3 Në rrethanat e përcaktuara në Kriterin 12.1, a kërkohet nga BPPJF-të të respektojnë kriteret e parashikuara sipas Rekomandimeve 6 dhe 8-11? (FATF R.12.2)
3.1.3/1 A kërkohet që BPPJF-të të vendosin sisteme të përshtatshme për menaxhimin e rrezikut për të përcaktuar nëse klienti i mundshëm, një klient apo pronari përfitues është person i ekspozuar politikisht? (FATF R.6.1)
3.1.3/2 A kërkohet që BPPJF-të të marrin miratimin e menaxherëve të nivelit të lartë për të vendosur marrëdhënie biznesi me një PEP? (FATF R.6.2)
3.1.3/3 Kur një klient është pranuar dhe klienti apo pronari përfitues është gjetur më pas të jetë, apo bëhet më pas një person i ekspozuar politikisht, a kërkohet që BPPJF-të të marrin miratimin e menaxherëve të nivelit të lartë për të vazhduar marrëdhënien e biznesit? (FATF R.6.2.1)
3.1.3/4 A kërkohet që BPPJF-të të ndërmarrin masat e arsyeshme për të vërtetuar burimin e pasurisë dhe burimin e fondeve të klientëve dhe pronarëve përfitues të identifikuar si persona të ekspozuar politikisht? (FATF R.6.3)
3.1.3/5 Kur BPPJF-të janë në marrëdhënie biznesi me një person të ekspozuar politikisht, a kërkohet që ato të bëjnë monitorimin e shtuar dhe të vazhdueshëm të asaj marrëdhënie? (FATF R.6.4)
3.1.3/6 A i përfshijnë kërkesat e mësipërme personat e ekspozuar politikisht të cilët mbajnë funksione të larta në vend? (FATF R.6.5)
3.1.3/7 A kërkohet që BPPJF-të të kenë politika apo të marrin masa të nevojshme për

parandalimin e shpërdorimit të zhvillimit teknologjik në skemat e pastrimit të parave apo të financimit të terrorizmit? (FATF R.8.1)
3.1.3/8 A kërkohet që BPPJF-të të kenë politika dhe procedura për trajtimin e çfarëdo rreziku specifik, të lidhur me marrëdhëniet apo transaksionet e bizneseve që nuk kryhen ballë për ballë? A zbatohen këto politika dhe procedura kur vendosen marrëdhëniet me klientët dhe kur kryhet vigjilenca e duhur e vazhdueshme ndaj klientit? (FATF R.8.2) <i>Shembuj të veprimeve ku mungon komunikimi ballë për ballë janë: marrëdhëniet e biznesit të kryera nëpërmjet internetit apo përmes mjeteve të tjera, siç janë përmes postës; shërbimet dhe transaksionet përmes internetit, përfshirë shitblerjen e letrave me vlerë përmes internetit nga investitorët me pakicë apo shërbimet e tjera interaktive kompjuterike; përdorimi i bankomatëve (ATM); shërbimet bankare përmes telefonit; transmetimi i udhëzimeve ose kërkesave nëpërmjet faksit ose mjeteve të ngjashme, si dhe bërja e pagesave dhe tërheqja e parave si pjesë e pikës elektronike të transaksionit të shitjes duke përdorur kartat me vlerë të parapaguara, rimbushëse apo të lidhura me llogarinë.</i>
3.1.3/9 A përfshijnë masat për menaxhimin e rrezikut procedura të VDK-së specifike dhe të efektshme që zbatohen për klientët që nuk takohen ballë për ballë? (FATF R.8.2.1) <i>Shembuj të procedurave të tilla janë: vërtetimi i dokumenteve të paraqitura; kërkimi i dokumenteve shitesë si plotësim i atyre që kërkohen për klientët e gjendur ballë për ballë; krijimi i kontakteve të pavarura me klientët; mbështetja në njoftimin nga pala e tretë (shih kriteret 9.1 deri në 9.5) dhe kërkesa që pagesa e parë të realizohet përmes llogarisë në emrin e klientit me një bankë tjetër që u nënshtrohet standardeve të ngjashme për vigjilencën e duhur ndaj klientit.</i> <i>Institucionet financiare duhet t'i referohen dokumentit të VDK-së, seksioni 2.2.6.</i> <i>Për shërbimet elektronike, institucionet financiare mund t'u referohen "Parimeve për menaxhimin e rrezikut për shërbimet bankare elektronike", të nxjerra nga Komisioni i Bazelit, i korrikut 2003.</i>
3.1.3/10 Shtrirja e nenit 13 (6) të Direktivës së BE-së 2005/60 është më e gjerë se ajo e Rek. 8 të FATF-së, sepse Direktiva fokusohet në produktet ose transaksionet pavarësisht nga përdorimi i teknologjisë. Si i mbulon Kosova këto çështje në legjislacionin e saj? (D3PP Neni 13 (6)).
3.1.3/11 A kërkohet që BPPJF-të të cilat mbështeten te një palë e tretë të marrin menjëherë informacionin e nevojshëm nga pala e tretë²⁰ lidhur me disa elementë të procesit të VDK-së (Kriteret 5.3 deri në 5.6)²¹? (FATF R.9.1)

²⁰ Kopjet e dokumenteve nuk janë të nevojshme për t'u siguruar.

²¹ Në praktikë, kjo mbështetje në palë të treta ndodh shpesh përmes njoftimeve të bëra nga ndonjë anëtar tjetër i të njëjtit grup për shërbime financiare, ose në disa shtete, nga institucioni tjetër financiar ose nga pala e tretë. Kjo mund të ndodhë edhe në marrëdhëniet e biznesit mes kompanive të sigurimit dhe ndërmjetësve/agjentëve të sigurimit ose midis ofruesve të pengut dhe ndërmjetësve.

3.1.3/12 A kërkohet që BPPJF-të të ndërmarrin hapa të duhur deri sa të binden që kopjet e të dhënave identifikuese dhe dokumentacioni përkatës tjetër lidhur me kërkesat për VDK-në do t'u vihen në dispozicion nga pala e tretë në bazë të kërkesës së bërë dhe pa vonesë? (FATF R.9.2)
3.1.3/13 A kërkohet që BPPJF-të të binden se pala e tretë është e rregulluar dhe e mbikëqyrur (në përputhje me Rekomandimin 23, 24 dhe 29), dhe se ka vënë në zbatim masat për t'i respektuar kërkesat e VDK-së të përcaktuara në R.5 dhe në R.10? (FATF R.9.3)
3.1.3/14 Në përcaktimin se në cilat vende mund të vendoset pala e tretë që i plotëson kushtet, a duhet që autoritetet kompetente të marrin parasysh informacionin në dispozicion lidhur me atë nëse ato vende zbatojnë në mënyrë të përshtatshme rekomandimet e FATF-së ²² ? (FATF R.9.4)
3.1.3/15 A bie përgjegjësia përfundimtare për identifikimin dhe verifikimin e klientit mbi BPPJF-në që mbështetet te pala e tretë? (FATF R.9.5)
3.1.3/16 A kërkohet që BPPJF-të të mbajnë të gjitha regjistrimet e domosdoshme për transaksionet, vendore dhe ndërkombëtare, për së paku pesë vite pas plotësimit të transaksionit (ose më gjatë nëse kërkohet nga një autoritet kompetent në raste të veçanta dhe në bazë të autoritetit të duhur)? (FATF R.10.1)
3.1.3/17 A janë regjistrimet e transaksioneve të mjaftueshme për të lejuar rindërtimin e transaksioneve individuale dhe për të siguruar, nëse është e nevojshme, dëshmi për ndjekjen penale të veprimtarisë kriminale? (FATF R.10.1.1)
3.1.3/18 A kërkohet që BPPJF-të të mbajnë regjistrime për të dhënat identifikuese, skedarët e llogarive dhe për korrespondencën e biznesit për së paku pesë vite pas mbylljes së një llogarie apo përfundimit të marrëdhënies së biznesit (ose më gjatë nëse kërkohet nga një autoritet kompetent në raste të veçanta dhe në bazë të autoritetit të duhur)? (FATF R.10.2)

²² Shtetet mund t'u referohen raporteve, vlerësimeve apo shqyrtimeve lidhur me LPP/LFT-në, të cilat janë të botuara nga FATF-ja, FSRB-të, FMN-ja apo nga Banka Botërore.

3.1.3/19 A kërkohet që BPPJF-të të sigurojnë që të gjithë regjistrimet për klientët dhe transaksionet dhe informacioni të jenë në dispozicion në kohën e duhur për autoritetet kompetente vendase në bazë të autoritetit të duhur? (FATF R.10.3)
3.1.3/20 A kërkohet që BPPJF-të t'u kushtojnë vëmendje të veçantë të gjitha transaksioneve të mëdha komplekse dhe të pazakonshme, ose modeleve të pazakonshme të transaksioneve, të cilat nuk kanë qëllim të dukshëm ekonomik apo të ligjshëm? (FATF R.11.1)
<i>Shembuj të këtyre transaksioneve apo modeleve të transaksioneve janë: transaksionet e mëdha në lidhje me një marrëdhënie ekzistuese të biznesit, transaksionet që kalojnë kufij të caktuar, qarkullim i lartë në llogari që është në mospërputhje me shumën e gjendjes në llogari apo transaksionet që dalin jashtë modelit të rregullt të veprimtarisë së llogarisë.</i>
3.1.3/21 A kërkohet që BPPJF-të të analizojnë sa më shumë që të jetë e mundur historikun dhe qëllimin e këtyre transaksioneve dhe të paraqesin konstatimet e tyre me shkrim? (FATF R.11.2)
3.1.3/22 A kërkohet që BPPJF-të t'i mbajnë këto gjetje të konstatimeve në dispozicion të autoriteteve kompetente dhe auditorëve për të paktën pesë vjet? (FATF R.11.3)

3.2 Raportimi i transaksioneve të dyshimta (R.16)

(aplikimi i R.13-15, 17 & 21)

3.2.1 A kërkohet nga BPPJF-të të jenë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Rekomandimin 13 (kriteret 13.1-13.4)²³ në rrethanat e mëposhtme: a) Kazinotë (ku përfshihen kazinotë në internet) dhe agjentët e pasurive të patundshme – në rrethanat e parashikuara në R.13. b) Tregtarët e metaleve apo gurëve të çmuar – në rastet kur bëjnë transaksione me para në dorë të barabarta ose më të larta se 15,000 USD/€²⁴. c) Avokatët, noterët dhe profesionistët e tjerë juridikë të pavarur, si dhe kontabilistët - në rastet kur, në emër të klientit apo për klientin, ata përfshihen në transaksione financiare lidhur me veprimtaritë si më poshtë:

²³ BPPJF-të duhet t'i respektojnë të gjitha kriteret e Rekomandimit 13, me dy përjashtime. I pari, tregtarët e metaleve dhe gurëve të çmuar duhet të respektojnë kriterin 13.3, por do t'u kërkohet t'i raportojnë transaksionet (apo transaksionet e tentuara) me para në dorë vetëm atëherë kur kalojnë kufirin prej 15,000 USD/€. I dyti, siç është shpjeguar në kriterin 16.1, shtetet mund t'ua lejojnë avokatëve, noterëve, profesionistëve të tjerë të pavarur juridikë, kontabilistëve që veprojnë si profesionistë të pavarur juridikë që t'i dërgojnë RTD-të e tyre pranë organizatave vetërregulluese, dhe ata nuk kanë nevojë që t'ia dërgojnë gjithmonë NjIF-it RTD-të e veta.

²⁴ Kufiri i përcaktuar përfshin situatat kur transaksioni kryhet në kuadër të një veprimi të vetëm apo në disa veprime që duket se janë të lidhura (rastet e "smurfing"/"structuring"/strukturimi apo copëzimi i shumave të transaksioneve nën kufijtë e përcaktuar duke iu shmangur regjistrimit apo raportimit të tyre.

- Blerja dhe shitja e pasurive të patundshme;
- Menaxhimi i parave, letrave me vlerë ose pasurive të tjera të klientëve;
- Menaxhimi i llogarive bankare, kursimeve apo të letrave me vlerë;
- Organizimi i kontributeve për krijimin, funksionimin ose menaxhimin e kompanive;
- Krijimi, funksionimi apo menaxhimi i personave a marrëveshjeve juridike, si dhe shitblerja e enteve të biznesit.

Shënim për privilegjet profesionale juridike apo për sekretin profesional juridik.

Nuk u kërkohet avokatëve, noterëve, profesioneve të tjera ligjore të pavarura dhe kontabilistëve që punojnë si profesionistë ligjorë të pavarur që të raportojnë transaksionet e dyshimta në rastet kur informacioni përkatës është marrë në rrethana në të cilat ata janë subjekt i sekretit profesional ose i privilegjit ligjor profesional.

Është në varësi të çdo juridiksioni të përcaktojë çështjet që duhet të konsiderohen si privilegj profesional ligjor ose sekret profesional. Kjo duhet të mbulojë normalisht informacionin që avokatët, noterët ose profesionistë të tjerë ligjorë të pavarur marrin ose sigurojnë nëpërmjet klientëve të tyre: (a) gjatë përcaktimit të pozitës juridike të klientit të tyre, ose (b) gjatë ushtrimit të detyrës së tyre si mbrojtës ose përfaqësues të klientit në procedurat gjyqësore, administrative, të arbitrazhit ose të ndërmjetësimit. Kur kontabilistët janë subjekt i detyrimeve të njëjta të sekretit ose privilegjit, atëherë edhe atyre nuk u kërkohet të raportojnë transaksionet e dyshimta.

d) Ofruesit e shërbimeve për trustet dhe kompanitë – kur përgatiten apo kryejnë transaksione në emër të klientit lidhur me veprimtaritë si më poshtë:

- veprojnë si agjentë themelues të personave juridikë;
- veprojnë si (ose i mundësojnë një personi tjetër të veprojë si) drejtor apo sekretar i kompanisë, partner i partneritetit ose në një pozicion të ngjashëm lidhur me personat e tjerë juridikë;
- sigurojnë një zyrë të regjistruar, adresë apo strehim për biznesin; adresë letërkëmbimi apo administrative për kompani, partneritet ose çdo person a marrëveshje tjetër juridike;
- veprojnë si (ose i mundësojnë një personi tjetër të veprojë si) i besuar i trustit të shprehur;
- veprojnë si (ose i mundësojnë një personi tjetër të veprojë si) aksionar i emëruar për një person tjetër.

(FATF R.16.1)

3.2.1/1 A kërkohet me ligj apo rregullore që BPPJF-të t'i raportojnë NjIF-it (Raportim i Transaksioneve të Dyshimta – RTD) kur ata dyshojnë apo kanë bazë të arsyeshme për të dyshuar që ato fonde janë të ardhura nga veprimtaria kriminale? (FATF R.13.1)

3.2.1/2 A zbatohet gjithashtu detyrimi për kryerjen e RTD-së për fondet kur ka arsye të besueshme për të dyshuar apo për të cilat dyshohet që ato janë të lidhura apo parashikohen të përdoren për terrorizëm, akte terroriste apo nga organizatat terroriste ose ata që financojnë terrorizmin? (FATF R.13.2)

3.2.1/3 A raportohen të gjitha transaksionet e dyshimta të lidhura me PP ose FT, përfshirë transaksionet në tentativë, pavarësisht shumës së transaksionit? (FATF R.13.3 and SR.IV.2)

3.2.1/4 A zbatohet kërkesa për raportimin e transaksioneve të dyshimta pavarësisht nëse mendohet se ato përfshijnë, ndër të tjera, edhe çështje tatimore? (FATF R.13.4 and SR.IV.2)
3.2.2 Në rastet kur vendet/juridiksionet u lejojnë avokatëve, noterëve, dhe profesionistëve të tjerë të pavarur ligjorë dhe kontabilistëve për t'i dërguar RTD tek organizatat e veta përkatëse vetërregulluese (OVR), a ekzistojnë forma të përshtatshme të bashkëpunimit në mes të këtyre organizatave dhe NjIF-it? A i ka përcaktuar Kosova detajet se si OVR mund të bashkëpunojë me NjIF-in? (FATF R.16.2)
3.2.3 Në rrethanat e përcaktuara në kriterin 16.1, a janë kriteret sipas Rekomandimit 14, 15 dhe 21 të aplikueshme në lidhje me BPPJF-të? (FATF R.16.3)
3.2.3/1 A janë BPPJF-të dhe drejtorët, zyrtarët e punonjësit e tyre (të përhershëm dhe të përkohshëm) të mbrojtur me ligj si nga përgjegjësia penale, ashtu edhe nga ajo civile për shkeljen e çdo kufizimi në dhënien e informacionit, të imponuara me kontratë apo me ndonjë dispozitë ligjore, administrative apo rregullatore, nëse ata i raportojnë dyshimet e tyre në mirëbesim te NjIF-i? (FATF R.14.1)
3.2.3/2 A ndalohen me ligj BPPJF-të dhe drejtorët, zyrtarët dhe punonjësit e tyre (të përhershëm dhe të përkohshëm) nga zbulimi i faktit se ndonjë RTD apo informatë e lidhur është duke iu raportuar apo dhënë NjIF-it? (FATF R.14.2)
3.2.3/3 A kërkohet që BPPJF-të të vendosin dhe të mbajnë procedura, politika dhe kontrolle të brendshme për parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit, si dhe t'ua komunikojnë ato punonjësve të tyre? A mbulojnë këto procedura, politika dhe kontrolle, ndër të tjera, VDK-në, mbajtjen e regjistrave, zbulimin e transaksioneve të pazakonshme dhe të dyshimta dhe detyrimin për raportim? (FATF R.15.1)
3.2.3/4 A kërkohet që BPPJF-të të bëjnë rregullimet e duhura për menaxhimin e përputhshmërisë? P.sh. duhet të paktën të caktohet zyrtari përgjegjës për përputhshmërinë me LPP/LFT-në në nivelin e menaxhimit? (FATF R.15.1.1)

3.2.3/5 A kanë qasje në kohë zyrtari i përputhshmërisë me LPP/LFT-në dhe punonjësit e tjerë të duhur në të dhënat identifikuese të klientit dhe në informata të tjera për VDK-në, në regjistra të transaksioneve dhe në informacionin tjetër përkatës? (FATF R.15.1.2)
3.2.3/6 A kërkohet që BPPJF-të të mbajnë një funksion auditi me burimet e duhura dhe të pavarur me qëllimin e testimit të përputhshmërisë (përfshirë testimin e shembujve) me këto procedura, politika dhe kontrole? (FATF R.15.2)
3.2.3/7 A organizojnë BPPJF-të trajnime të vazhdueshme për të punësuarit për t'u siguruar që punonjësit të mbahen të informuar për zhvillimet e reja, përfshirë informacionin për teknikat, metodat dhe prirjet e tanishme të PP-së dhe FT-së; dhe a ekzistojnë shpjegime të qarta për të gjitha aspektet e ligjeve dhe detyrimeve për LPP/LFT-në dhe, në veçanti, për kërkesat lidhur me VDK-në dhe raportimin e transaksioneve të dyshimta? (FATF R.15.3)
3.2.3/8 A kërkohet që BPPJF-të të krijojnë procedura të kontrollit për të siguruar standarde të larta në lidhje me punësimin e punonjësve? (FATF R.15.4)
3.2.3/9 A është zyrtari përgjegjës për përputhshmërinë me LPP/LFT-në në gjendje të veprojë në mënyrë të pavarur dhe t'i raportojë nivelit të tij epror që afrohet me nivelin e raportimit apo bordin e drejtorëve? (FATF R.15.5)
3.2.3/10 A kërkohet që BPPJF-të t'u kushtojnë vëmendje të veçantë marrëdhënieve të biznesit dhe transaksioneve me persona (përfshirë personat juridikë, BPPJF-të e tjera dhe institucionet financiare) nga apo në shtetet, të cilat nuk i zbatojnë rekomandimet e FATF-së apo nuk i zbatojnë ato në mënyrë të mjaftueshme? (FATF R.21.1)
3.2.3/11 A ka Kosova masa të efektshme për t'u siguruar që institucionet financiare të jenë të njoftuara për shqetësimet rreth dobësive në sistemet e LPP/LFT-së së shteteve/juridiksioneve të tjera? (FATF R.21.1.1)

3.2.3/12 Nëse këto transaksione nuk kanë qëllim të qartë ekonomik apo në dukje të ligjshëm, a shqyrtohen, për aq sa është e mundur, prejardhja dhe qëllimi i atij transaksioni dhe a vihen në dispozicion konstatimet me shkrim për të ndihmuar autoritetet kompetente (p.sh. mbikëqyrësit, agjencitë për zbatimin e ligjit dhe NjIF-in), si dhe auditorët? (FATF R.21.2)
3.2.3/13 Në rastet kur një shtet/juridiksion vazhdon të mos zbatojë rekomandimet e FATF-së apo nuk i zbaton ato sa duhet, a është Kosova në gjendje të zbatojë kundërmasa të përshtatshme? (FATF R.21.3)
<i>Shembuj të kundërmasave të mundshme janë:</i> - Kërkesat e rrepta për identifikimin e klientëve dhe përmirësimi i këshillave, përfshirë këshillat specifike financiare për juridiksionin e atij shteti, për institucionet financiare me qëllimin e identifikimit të pronarëve përfitues para krijimit të marrëdhënieve të biznesit me individë apo kompani nga këto shtete; - Mekanizma të përmirësuar raportues apo raportim sistematik i transaksioneve financiare në bazë të asaj që transaksionet financiare me këto shtete kanë më shumë gjasa të jenë të dyshimta; - Gjykimi i kërkesave për miratimin e themelimit në shtetet që zbatojnë kundërmasën të degëve apo zyrave përfaqësuese të institucioneve financiare, duke marrë parasysh faktin që institucioni përkatës financiar vjen nga vendi që nuk ka sisteme të duhura të LPP/LFT-së; - Paralajmërimi i bizneseve nga sektori jofinanciar që transaksionet me personat fizikë apo juridikë në atë shtet mund të përmbajnë rrezikun e pastrimit të parave. - Kufizimi i marrëdhënieve të biznesit apo i transaksioneve financiare me shtetin apo personat e identifikuar në atë shtet.
3.2.4 A shtrihet kërkesa e raportimit edhe te veprimtaritë e tjera profesionale të kontabilistëve, përfshirë auditimin? (FATF R.16.5)
3.2.5 A kërkohet nga BPPJF-të të raportojnë tek NjIF-i kur dyshojnë apo kanë bazë të arsyeshme për të dyshuar se fondet janë përfitime nga të gjitha veprimet kriminale që në atë vend do të përbënin vepër penale bazë të pastrimit të parave? (FATF R.16.6)
3.2.6 Luteni të ofroni statistika të detajuara në lidhje me raportet e transaksioneve të dyshimta të bëra nga BPPJF-të për NJIF-in për 2010-2013. (FATF R.32)
3.2.7 Luteni të tregoni nëse Kosova kërkon që personat e mbuluar të mos kryejnë transaksione të cilat ata kanë dijeni ose dyshojnë se lidhen me pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit deri sa të kenë raportuar te NJIF-i (D3PP Neni 24(1)).

3.2.8 Luteni të tregoni nëse autoritetet e Kosovës (NJIF-i për shembull) mund të ndalojnë ekzekutimin e transaksioneve që janë sjellë në vëmendjen e tyre (D3PP Neni 24(1)).
3.2.9 Për më tepër, ju lutemi tregoni nëse, kur transaksioni është kryer për shkaqe të arsyeshme ose për shkak se mund të pengojë përpjekjet e një hetimi, a vendos Kosova një kërkesë që NJIF-i të informohet menjëherë më pas? (D3PP Neni 24(2))
3.2.10 Në vijim të 3.2.4 (Rek. 16.5 FATF), ju lutemi tregoni nëse Kosova kërkon që ndalimi në zbulimin e informacionit, dhe kërkesa për zhvillimin e masave të brendshme të LPP/LFT-së në lidhje me shtetet që nuk zbatojnë standardet e LPP/LFT-së janë gjithashtu të zbatueshme për auditorët, kontabilistët dhe këshilltarët tatimorë kur veprojnë në ushtrimin e aktiviteteve të tyre profesionale? (D3PP Neni 2(3)(a))
3.2.11 Gjithashtu, luteni të tregoni nëse Kosova kërkon zbatimin e 3.2.7/4 më lart për të gjithë personat fizikë dhe juridikë që tregtojnë mallra kur pagesat janë bërë në para të gatshme në vlerën prej 15,000 € ose më shumë (D3PP Neni 2(3)(e))

3.3 Rregullimi, mbikëqyrja dhe monitorimi (R.24-25)

Rekomandimi 24

3.3.1 A siguron Kosova se kazinotë (përfshirë kazinotë e internetit) i nënshtrohen një regjimi të plotë rregullator dhe mbikëqyrës, përmes të cilit sigurohet se ato zbatojnë në mënyrë të efektshme masat e LPP/LFT-së, të kërkuara sipas rekomandimeve të FATF-së? (FATF R.24.1)
3.3.2 A siguron Kosova se një autoritet i përcaktuar kompetent ka përgjegjësinë për regjimin rregullator dhe mbikëqyrës të LPP/LFT-së? A ka autoriteti kompetenca të duhura për zbatimin e funksioneve të tij, përfshirë kompetencat për monitorimin dhe zbatimin e dënimeve (duhet të sigurohet se kriteret 17.1-17.4 aplikohen për detyrimet sipas R.12 dhe R.16)
3.3.2/1 A ka Kosova sanksione penale, civile apo administrative në fuqi që janë efektive,

proporcionale dhe shtrënguese për personat fizikë apo juridikë (në lidhje me kazinotë), të cilët nuk i respektojnë kushtet për luftimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit? (FATF R.17.1)
3.3.2/2 A ka përcaktuar Kosova një autoritet (p.sh. mbikëqyrësit apo NjIF-i) me kompetencë për zbatimin e sanksioneve në lidhje me kazinotë? (FATF R.17.2)
3.3.2/3 A ka sanksione në fuqi në lidhje jo vetëm me personat juridikë që janë institucione financiare apo biznese (në lidhje me kazinotë) por edhe me drejtorët dhe menaxherët e lartë të tyre? (FATF R.17.3)
3.3.2/4 A janë llojet e sanksioneve në dispozicion të gjera dhe në përpjesëtim me peshën e situatës? A përfshijnë sanksionet kompetencën për të dhënë sanksione disiplinore dhe financiare dhe kompetencën për të tërhequr, kufizuar apo pezulluar licencën e institucionit financiar (në lidhje me kazinotë), aty ku është e zbatueshme? (FATF R.17.4)
3.3.3 A licencohen kazinotë nga një autoritet kompetent i caktuar? (FATF R.24.1.2)
3.3.4 A janë masat e nevojshme ligjore dhe rregullative të ndërmarra nga një autoritet kompetent për të parandaluar kriminelët ose bashkëpunëtorët e tyre që të mbajnë ose të jenë pronarë përfitues të interesave të mëdha ose kontrolluese, të kenë funksione menaxhimi ose të jenë operatorë kazinosh? (FATF R.24.1.3)
3.3.5 A siguron Kosova se kategoritë e tjera të BPPJF u nënshtrohen sistemeve të efektshme për monitorimin dhe sigurimin e përputhshmërisë me kërkesat e LPP/LFT-së? Në përcaktimin e asaj nëse sistemi për monitorimin dhe sigurimin e përputhshmërisë është i duhur, duhet të merret parasysh rreziku i pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në atë sektor p.sh. nëse ekziston rrezik i ulët i dëshmuar, atëherë shtrirja e masave të kërkuara mund të jetë më e vogël. (FATF R.24.2)
3.3.6 A ekziston autoritet kompetent i caktuar apo OVRP përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e përputhshmërisë të kategorive të tjera të BPPJF-ve me kërkesat e parashikuara të LPP/LFT-së? A ka autoriteti i tillë ose OVRP: a) Kompetencat e duhura për zbatimin e funksioneve të tij, përfshirë kompetencat për monitorimin

dhe zbatimin e dënimeve (shtetet duhet të sigurojnë që të zbatohen kriteret 17.1-17.4 për detyrimet sipas R.12 dhe R.16);

b) Burime të mjaftueshme teknike dhe të tjera për kryerjen e funksioneve të veta²⁵? (FATF R.24.2.1)

3.3.6/1 A ka Kosova sanksione penale, civile apo administrative në fuqi që janë efektive, proporcionale dhe shtrënguese për personat fizikë apo juridikë (kur janë kategori të tjera të BPPJF-ve), të cilët nuk i respektojnë kushtet për luftimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit? (FATF R.17.1)

3.3.6/2 A ka përcaktuar Kosova një autoritet (p.sh. mbikëqyrësit apo NjIF-i) me kompetencë për zbatimin e sanksioneve ndaj kategorive të tjera të BPPJF-ve? (FATF R.17.2)

3.3.6/3 A ka sanksione në fuqi në lidhje jo vetëm me personat juridikë që konsiderohen se janë të kategorive të tjera të BPPJF-ve por edhe me drejtorët dhe menaxherët e lartë të tyre? (FATF R.17.3)

3.3.6/4 A janë llojet e sanksioneve në dispozicion të gjera dhe në përpjesëtim me peshën e situatës? A përfshijnë sanksionet kompetencën për të dhënë sanksione disiplinore dhe financiare dhe kompetencën për të tërhequr, kufizuar apo pezulluar licencën e institucionit financiar, aty ku është e zbatueshme (në lidhje me kategori të tjera të BPPJF-ve)? (FATF R.17.4)

3.3.6/5 A janë mbikëqyrësit e të gjitha kategorive të BPPJF-ve të strukturuar, të financuar dhe të plotësuar siç duhet me personelin e nevojshëm si dhe a janë të siguruar me burime të mjaftueshme teknike dhe të tjera që të mund të kryejnë plotësisht dhe në mënyrë efektive detyrat e tyre? Strukturimi i duhur përfshin nevojën për pavarësi dhe autonomi të mjaftueshme funksionale për të siguruar lirinë nga ndikimi apo ndërhyrja e parregullt²⁶. (FATF R.30.1)

²⁵ Në vlerësimin e përputhshmërisë me këtë kriter, vlerësuesit duhet të kenë parasysh kriteret 30.1 deri në 30.4, në rastet kur një gjë e tillë është e duhur (në varësi të llojit të autoritetit kompetent të përcaktuar ose OVR-së, madhësisë së tij, përgjegjësisë, etj.).

²⁶ Nëse NJIF i ndonjë shteti nuk përputhet me kërkesën për të pasur pavarësi dhe autonomi të mjaftueshme funksionale (kriteri 26.6), shteti duhet vetëm të vlerësohet poshtë në Rekomandimin 26.

3.3.6/6 A kërkohet që personeli i mbikëqyrësve të të gjitha kategorive të BPPJF-ve të mbajë standarde të larta të profesionalizmit, përfshirë standardet në lidhje me konfidencialitetin, integritetin/ndershmërinë dhe aftësitë e duhura? (FATF R.30.2)
3.3.6/7 A i është ofruar personelit të mbikëqyrësve të të gjitha kategorive të BPPJF-ve trajnim përkatës dhe i përshtatshëm për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit? (FATF R.30.3)
3.3.6/8 A janë organet mbikqyrëse të obliguara të informojnë autoritetet përgjegjëse për luftimin e pastrimit të parave nëse, gjatë inspektimeve mbikqyrëse, zbulojnë se do të mund të përbënin dëshmi të pastrimit të parave? (Direktiva e BE-së 2005/60/EC Neni 25(1))

Rekomandimi 25 (Udhëzim për BPPJF-të tjetër nga udhëzimi për RTD)

3.3.7 A kanë hartuar autoritetet kompetente udhëzime ²⁷ të cilat i asistojnë institucionet financiare dhe BPPJF-të për të implementuar dhe dhe respektuar kërkesat përkatëse për LPP/LFT-në? Për BPPJF-të, këto udhëzime mund të hartohen nga OVR-rr-të. (FATF R.25.1)

²⁷ Udhëzimet duhet që të paktën të ndihmojnë për çështjet e mbuluara nga rekomandimet përkatëse të FATF-së, duke përfshirë: (i) përshkrimin e teknikave dhe metodave të PP-së dhe FT-së dhe (ii) çdo masë shtesë që këto institucione dhe BPPJF-të do të mund të marrin për të siguruar se masat e tyre të LPP/LFT-së janë të efektshme.

3.4 Bizneset dhe profesionet e tjera jo financiare (R.20.1)

3.4.1 A e ka konsideruar Kosova mundësinë e aplikimit të Rekomandimeve 5, 6, 8-11, 13-15, 17 dhe 21 për bizneset dhe profesionet jofinanciare (të tjera nga BPPJF-të) të cilat rrezikohen të keqpërdoren për pastrim të parave ose financim të terrorizmit? (FATF R.20.1)

Shembuj të bizneseve apo profesioneve që mund të jenë në rrezik janë: tregtarët e mallrave me vlerë të lartë apo atyre luksoze, dyqanet e mallrave të lëna peng, lojërat e fatit, shtëpitë e ankandeve dhe këshilltarët e investimeve.

3.4.2 A ka implementuar Kosova kërkesën e detyruar në Nenin 4 të Direktivës për t'i shtrirë obligimet e LPP/LFT-së tek profesionistët dhe kategoritë e tjera të sipërmarrjeve të cilat mund të shfrytëzohen për qëllime të pastrimit të parave apo financimit të terrorizmit? A është ndërmarrë ndonjë vlerësim rreziku në lidhje me këtë? (Direktiva BE-së 2005/60/EC Neni 4(1))

4. Marrëveshjet Ligjore - Qasja në pronësinë përfituese dhe informacioni i kontrollit (R.34)

4.1 A ka ndërmarrë Kosova masa për të parandaluar përdorimin e paligjshëm të marrëveshjeve juridike në lidhje me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, duke siguruar që ligjet e tyre për çështje tregtare, të trustit dhe ligje të tjera të kërkojnë transparencën e duhur në lidhje me pronësinë përfituese dhe kontrollin e trusteve dhe të marrëveshjeve të tjera juridike? (FATF R.34.1)

Shembuj të mekanizmave të cilat mund të përdoren për të siguruar se ka transparencë të duhur mund të përfshijnë:

1. Një sistem të regjistrimit qendror ku në një regjistër shtetëror regjistrohen të dhëna të hollësive për trustet (p.sh. themeluesin e trustit, të besuarit, përfituesit dhe mbrojtësit) dhe të marrëveshjeve të tjera juridike të regjistruar në atë shtet. Informacioni përkatës mund të jetë në dispozicion të qytetarëve apo vetëm në dispozicion të autoriteteve kompetente. Ndryshimet në informacionin lidhur me pronësinë dhe kontrollin do të duhet të mbahen të përditësuara.

2. Kërkesa të parashtruara ndaj ofruesve të shërbimeve të trusteve që të marrin, verifikojnë dhe të mbajnë regjistrime për hollësitë e trustit ose të marrëveshjeve të tjera juridike të ngjashme.

3. Mbështetja në kompetencat hetuese dhe kompetencat e tjera të autoriteteve për zbatimin e ligjit, atyre rregullatore, mbikëqyrëse apo autoriteteve të tjera kompetente në ndonjë juridiksion për të marrë informacion apo për të pasur qasje në të.

Këto mekanizma janë, në një masë të madhe, plotësuese dhe vendet mund t'i shohin si shumë të dëshirueshme dhe të dobishme për t'i përdorur në mënyrë të kombinuar.

Në varësi të shkallës së mbështetjes në kompetencat hetimore të autoriteteve të tyre kompetente, këto autoritete duhet të kenë kompetenca të detyrueshme mjaft të fuqishme për qëllime të marrjes së informacionit përkatës.

Çfarëdo mekanizmi që të përdoret, është thelbësore që: (a) autoritetet kompetente të kenë mundësi të marrin apo të kenë qasje në kohë në informacionin për pronësinë përfituese dhe kontrollin, (b) informacioni të jetë i duhur, i saktë dhe të merret në kohë (shih kriterin 34.2) dhe (c) autoritetet kompetente të kenë mundësi t'i ndajnë këto informata me autoritetet e tjera kompetente brenda dhe jashtë vendit.

4.2 A kanë autoritetet kompetente mundësi të marrin apo të kenë qasje në kohën e përshtatshme në informata të duhura, të sakta dhe aktuale për pronësinë përfituese dhe për kontrollin e marrëveshjeve juridike, si dhe në veçanti, për themeluesin, të besuarin dhe për përfituesit e trusteve të shprehura? (FATF R.34.2)

4.3 A ekzistojnë masa për të lehtësuar qasjen nga institucionet financiare në informacionin për pronësinë përfituese dhe kontrollin, në mënyrë që ato të mund t'i verifikojnë më me lehtësi të dhënat identifikuese të klientëve? (FATF R.34.3)

5. *Bashkëpunimi ndërkombëtar*²⁸

5.1 Ndhimja e ndërsjellë juridike (R.36, R.37, SR.V & R.32)

Rekomandimi 36²⁹ (Ndhimja e ndërsjellë juridike)

5.1.1 Ju lutem jepni një listë të detyrimeve shumëpalëshe të bazuara në traktate të cilat kanë të bëjnë me ndihmën ligjore në çështjet penale (përfshirë veprat penale të pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit) të cilat zbatohen në Kosovë.
5.1.2 A është Kosova në gjendje të ofrojë gamën më të gjerë të mundshme të ndihmës së ndërsjellë juridike për hetimet, ndjekjet penale dhe procedurat e tjera përkatëse të LPP/FT ³⁰ ? (FATF R.36.1)
5.1.3 A është Kosova në gjendje ta ofrojë këtë ndihmë në kohë të arsyeshme dhe në mënyrë konstruktive dhe efektive? (FATF R.36.1.1)
5.1.4 A ka ndonjë pengesë për ofrimin e ndihmës së ndërsjellë juridike? (FATF R.36.2)
5.1.5 A ka Kosova procese të qarta dhe efektive për ekzekutimin e kërkesave për ndihmë të ndërsjellë juridike në një kohë të arsyeshme dhe pa vonesa të panevojshme? (FATF R.36.3)
5.1.6 A mund të refuzohet ndonjë kërkesë për ndihmë të ndërsjellë juridike me arsyetimin e vetëm se vepra konsiderohet gjithashtu se përfshin çështje tatimore? (FATF R.36.4)
5.1.7 A mund të refuzohet ndonjë kërkesë për ndihmë të ndërsjellë juridike me arsyetimin e ligjeve që parashikojnë kërkesa për fshehtësinë apo konfidencialitetin kundrejt institucioneve financiare apo BPPJF-ve, përveç rasteve ku informatat përkatëse janë marrë në rrethana ku zbatohet privilegji profesional ligjor apo fshehtësia profesionale ligjore? (FATF R.36.5)

²⁸ R.35 dhe SR.I, të cilat në mes tjerash përcaktojnë kërkesa për nënshkrimin dhe ratifikimin e instrumenteve të BE-së, janë përjashtuar nga vlerësimi për shkak të mos aplikueshmërisë në rastin e Kosovës.

²⁹ Edhe pse ky Rekomandim ishte pjesë e ciklit 1 të vlerësimit të projektit PECK, ai është përfshirë në këtë seksion të pyetësorit për hir të koherencës meqenëse i referohet të njëjtës çështje.

³⁰ Ndhimja e ndërsjellë juridike duhet të përfshijë ndihmën e kësaj natyre: (a) prodhimin, kërkimin dhe sekuestrimin e informacionit, dokumenteve apo të provave (përfshirë regjistrimet/shënimet financiare) nga institucionet financiare apo personat e tjerë fizikë apo juridikë; (b) marrjen e provave apo të deklaratave nga personat; (c) ofrimin e origjinaleve apo të kopjeve të dokumenteve apo regjistrimeve përkatëse dhe të çdo informate tjetër apo elementi provues, (d) ndikimin e shërbimit të dokumenteve gjyqësore; (e) lehtësimin e shfaqjes vullnetare të personave me qëllimin e sigurimit të informatave apo të dëshmimeve për juridiksionin që i kërkon ato dhe (f) identifikimin, ngrirjen, sekuestrimin, apo konfiskimin e pasurive të pastruara apo të synuara për t'u pastruar, të ardhurat nga pastrimi i parave dhe pasuritë e përdorura apo që synohet të përdoren për financimin e terrorizmit, si dhe instrumentet e këtyre veprave dhe pasuritë në vlerë përkatëse.

5.1.8 A kanë autoritetet kompetente kompetenca në dispozicion për t'i përdorur për përgjigjet ndaj kërkesave për ndihmë të ndërsjellë juridike? (FATF R.36.6)
5.1.9 Për të shmangur konflikte të juridiksionit, a ka shqyrtuar Kosova mundësinë që të krijohen dhe të përdoren mekanizma për përcaktimin e vendit më të mirë për ndjekjen penale të të pandehurve në interes të drejtësisë për rastet që i nënshtrohen ndjekjes penale në më shumë se një juridiksion? (FATF R.36.7)
5.1.10 A janë kompetencat e autoriteteve kompetente që kërkohen në R.28 në dispozicion për t'u përdorur aty ku ka kërkesë të drejtpërdrejtë nga autoritetet e jashtme gjyqësore apo ato të zbatimit të ligjit ndaj homologëve vendas? (FATF R.36.8)
5.1.11 A e lejon juridiksioni juaj ekstradimin e shtetasve në rastet e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit? Nëse jo, nën cilat kushte autoritetet kompetente në juridiksionin tuaj i ndjekin penalisht ata?
5.1.12 Ju lutem tregoni cilat konventa dhe traktate ndërkombëtare për luftimin kundër pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit planifikohen të ratifikohen në të ardhmen.

Rekomandimi 37 (Penalizimi i dyfishtë në lidhje me ndihmën e ndërsjellë juridike)

5.1.13 A jepet ndihma e ndërsjellë juridike në mungesë të penalizimit të dyfishtë, në veçanti, për masa më pak ndërhyrëse dhe detyruese? (FATF R.37.1)
5.1.14 Për ato lloje të ndihmës së ndërsjellë juridike ku kërkohet penalizimi i dyfishtë, a ka Kosova si palë e kërkuar (që ofron asistencë) ndonjë pengesë ligjore ose praktike për të dhënë ndihmën kur sjellja që i paraprin veprës penale kriminalizohet në të dy juridiksionet? A parashtrajnë ndonjë pengesë në ofrimin e ndihmës së ndërsjellë juridike dallimet teknike në ligje tek palët kërkuuese dhe të kërkuara, siç janë dallimet në mënyrën se si secili juridiksion i kategorizon veprat penale? (FATF R.37.2)

Rekomandimi 32 (në lidhje me ndihmën e ndërsjellë juridike)

5.1.15 Luteni të ofroni statistika vjetore mbi: (c) Ndihmën e ndërsjellë juridike apo kërkesat e tjera ndërkombëtare për bashkëpunim; o Të gjitha kërkesat për ndihmë të ndërsjellë juridike (përfshirë kërkesat për ngrirjen, sekuestrimin

dhe konfiskimin) që dërgohen apo pranohen, lidhur me pastrimin e parave, veprat penale kryesore dhe financimin e terrorizmit, përfshirë natyrën e kërkesës, qoftë nëse është pranuar apo refuzuar, dhe kohën e kërkuar për përgjigje. (FATF R.32.2)

5.1.16 Luteni të ofroni statistika gjithëpërfshirëse mbi:

c) kërkesat e tjera formale për ndihmë të dhënë ose të marrë nga autoritetet e zbatimit të ligjit në lidhje me PP apo FT, përfshirë rastet kur kërkesa është pranuar ose refuzuar. (FATF R.32.3)

5.2 Ndihma e ndërsjellë juridike për konfiskimin dhe ngrirjen e pasurisë (R.38)

5.2.1 A ka ligje dhe procedura të duhura për dhënien e përgjigjes efektive dhe në kohë të arsyeshme ndaj kërkesave për ndihmë të ndërsjellë juridike të shteteve të huaja në lidhje me identifikimin, ngrirjen, sekuestrimin apo konfiskimin e:

(a) pronës së pastruar nga,

(b) të ardhurave nga,

(c) instrumenteve të përdorura në, apo

(d) instrumenteve të synuara për t'u përdorur në,

kryerjen e ndonjë vepre të pastrimit të parave, financimit të terrorizmit apo të ndonjë vepre tjetër kryesore që qëndron pas tyre? (FATF R.38.1)

5.2.2 A plotësohen kushtet e lartpërmendura edhe kur kërkesa ka të bëjë me pronë të vlerës përkatëse? (FATF R.38.2)

5.2.3 A ka pasur Kosova marrëveshje për bashkërendimin e veprimeve të sekuestrimit dhe të konfiskimit me vende të tjera? (FATF R.38.3)

5.2.4 A e ka shqyrtuar Kosova mundësinë e themelimit të një fondi të pasurive të konfiskuara në të cilin do të depozitohen të gjitha apo ndonjë pjesë e pasurive të konfiskuara dhe i cili do të përdoret për qëllime të zbatimit të ligjit, shëndetësisë, arsimit apo qëllime të tjera të përshtatshme? (FATF R.38.4)

5.2.5 A e ka marrë parasysh Kosova çështjen e autorizimit të ndarjes së pasurive të konfiskuara midis tyre kur konfiskimi është drejtpërdrejt apo tërthorazi rezultat i veprimeve të bashkërenduara për zbatimin e ligjit? (FATF R.38.5)

5.2.6 A njihen dhe zbatohen urdhrat që vijnë nga jashtë në lidhje me konfiskimet jopenale? (FATF R.38.6)

--

5.3 Ekstradimi (R.39, R.37, SR.V dhe R.32)

5.3.1 A është pastrimi i parave një vepër penale e ekstradueshme? Luteni të përmendni ligjet dhe procedurat e aplikuara për të ekstraduar individë që akuzohen për kryerje të veprës së pastrimit të parave (FATF R.39.1)
5.3.2 a) A ekstradohen shtetasit e vet? b) Në rast të mosekstradimit të shtetasve të vet vetëm për arsye të shtetësisë, a e dorëzon Kosova, në bazë të kërkesës së juridiksionit që kërkon ekstradimin, rastin pa vonesë tek autoritetet e veta kompetente me qëllim të ndjekjes penale të paraparë në kërkesë? Në raste të tilla, a i marrin autoritetet kompetente vendimet dhe i zhvillojnë procedurat e tyre gjyqësore në mënyrë të njëjtë si në rast të çfarëdo vepre penale tjetër të natyrës serioze sipas ligjit vendor të atij juridiksioni? (FATF R.39.2)
5.3.3 Në rastin e referuar në kriterin 39.2 (b), a bashkëpunon Kosova me juridiksionet e tjera, në veçanti mbi aspektet procedurale dhe provuese, për të siguruar efektivitetin e ndjekjes penale? (FATF R.39.3)
5.3.4 Në pajtim me parimet e ligjit vendor, a ka adoptuar Kosova masa ose procedura që do të mundësonin trajtimin pa vonesa të paarsyeshme të kërkesave për ekstradim dhe të procedurave gjyqësore që lidhen me pastrimin e parave? (FATF R.39.4)
5.3.5 A ekzistojnë procedura të thjeshtuara të ekstradimit përmes mundësimin të dërgimit të drejtpërdrejtë të kërkesave për ekstradim ndërmjet ministrive përkatëse? A mund të ekstradohen personat vetëm në bazë të urdhërarresteve apo të aktgjytimeve? A ka procedurë të thjeshtuar të ekstradimit të personave që pranojnë fajin dhe që heqin dorë nga procedurat formale të ekstradimit? (FATF R.39.5)

Rekomandimi 37 (Penalizimi i dyfishtë në lidhje me ekstradimin)

5.3.6 Për ekstradimin ku kërkohet penalizimi i dyfishtë, a ka Kosova si palë e kërkuar (që ofron asistencë) ndonjë pengesë ligjore ose praktike për të dhënë ndihmën kur sjellja që i paraprin veprës penale kriminalizohet në të dy juridiksionet? A parashtrajnë ndonjë pengesë në ofrimin e ndihmës së ndërsjellë juridike dallimet teknike në ligje tek palët kërkuuese dhe të kërkuara, siç janë dallimet në mënyrën se si secili juridiksion i kategorizon veprat penale? (FATF R.37.2)

--

Rekomandimi 32 (lidhur me ekstradimin)

5.3.7 Luteni të ofroni statistika gjithëpërfshirëse mbi:
(c) Të gjitha kërkesat për ekstradim të kryera ose të marra, në lidhje me PP, veprat penale kryesore dhe FT, përfshirë rastet kur kërkesa është pranuar ose refuzuar, dhe kohën e kërkuar për përgjigje. (FATF R.32.2)

6. Shtojca

6.1 Shtojca I – Struktura dhe mbikëqyrja e BPPJF-ve

Lloji i biznesit	Mbikëqyrësi	Nr. i institucioneve të regjistruara
1. Kazinotë (përfshirë kazinotë në internet)		
2. Agjentët e paluajtshmërive		
3. Tregtarët me metale dhe gurë të çmuar		
4. Tregtarët me gurë të çmuar		
5. Avokatët, noterët, profesionistët e tjerë të pavarur ligjorë - kjo i referohet praktikuesve solo, partnerëve apo profesionistëve të punësuar brenda firmave profesionale. Nuk është synuar që të nënkuptojë profesionistë të "brendshëm" të cilët janë të punësuar të llojeve të tjera të bizneseve, e as profesionistë që punojnë për agjenci qeveritare, të cilët mund t'u jenë nënshtruar tashmë masave të cilat luftojnë pastrimin e parave.		
6. Ofruesit e Shërbimeve të Trustit dhe të Kompanive u referohet të gjithë personave ose bizneseve që nuk janë të mbuluar dikund tjetër.		

6.2 Shtojca 2: Shkurtime

Shkurtimi	Përshkrimi
BPPJF	Bizneset dhe Profesionet e Përcaktuara Jofinanciare
CETS	Seria e Traktateve të Këshillit të Evropës
D3PP	Direktiva e Tretë për Pastrimin e Parave (2005/60/EC)
FATF	Task Forca e Veprimit Financiar
IKM	Instrument i këmbyesëm i mbajtësit
LPP/FT	Luftimi i Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit
NJN	Ndihma Juridike e Ndërsjellë
NJIF	Njësia e Inteligjencës Financiare
OJF	Organizatë Jofitimprurëse
OVR	Organizata Vetërregulluese
PEP	Personat e Ekspozuar Politikisht
PP	Pastrimi i parave
PKEK	Projekti kundër Krimit Ekonomik në Kosovë
RTD	Raport i Transaksionit të Dyshimtë
RV	Rekomandim i Veçantë (9 Rekomandimet e Veçanta të FATF-së për Financimin e Terrorizmit)
RVN	Raport i Vlerësimit të Ndërsjellë
S/RES	Rezolutë e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara
STE	Seria e Traktateve Evropiane
TPV	Transferimi i Parasë apo Vlerës
VDK	Vigjilenca e Duhur ndaj Klientit